



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS**  
**SENATI AKADEMIK**

Nr. 2021 Prot.

Tiranë, më 08/09 /2023

**VENDIM**

**Nr. 19, datë 08.09.2023**

**PËR**  
**MIRATIMIN E PROPOZIMIT PËR NDRYSHIME NË STRUKTURËN E**  
**UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS**

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38, pika 1, germa ç, Statutin e UPT-së, neni 9, pika 3, germa c, në Udhëzimin e MASR Nr. 27, datë 29.12.2017 "Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë", në relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike, datë 07.09.2023 të Universitetit Politeknik të Tiranës, Senati Akademik në mbledhjen e datës 08.09.2023,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë krijimin e Degëve të Burimeve Njerëzore në njësitë kryesore të UPT-së të përbërë nga pozicioni: Kryetar i Degës së Burimeve Njerëzore dhe pozicionet Specialist i IT dhe Specialist i SBC, Alumni dhe Karrierës në secilin nga 7 fakultetet e UPT-së.
2. Të miratojë krijimin e Degës së Burimeve Njerëzore në Institutin e Gjeoshkencave, në varësi do të jenë pozicionet e Specialistit të Arkivit Shkencor dhe Specialistit të IT.
3. Pozicioni aktual i Specialistit të Personelit dhe Arkivit riorganizohet në pozicionin Kryetar i Degës së Burimeve Njerëzore.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

**Prof. Dr. Andrea Maliqari**

